



Viti i VI-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2015

MUNGESA E INFORMIMIT PUBLIK NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E DEKONGJESTIONANTËVE TË SFERËS SË ORL-SË

Joana Hankollari

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Tiranë

Adresë kontakti: joanahankollari@gmail.com

Përmbledhje

Hyrje: Në American Journal of Emergency Medicine (2007) bëri bujë raportimi i rastit të një pacienti 45 vjeçar, që pësoi ishemi cerebrale pas një historie të gjatë të përdorimit të nafazolinës nazale. Pacienti nuk kishte faktorë risku për evente cerebrovaskulare. Në shumë studime botërore është ngritur hipoteza që përdorimi i pa bazuar në guidelines botërore i dekonjestionantëve të sferës së ORL shkakton probleme neurologjike, kardiovaskulare.

Qëllimi: Ky studim ka qëllim të sigurojë informacion për Shqipërinë për mënyrën e përdorimit të këtyre medikamenteve dhe për informimin ndaj efekteve të padëshiruara të tyre.

Metodologjia: Studimi përfshiu 300 individë që dilnin vullnetarë për të plotësuar anketën mbi këto medikamente në tendën përkatëse. Individëve iu shpjegua për cilat medikamente zhvillohej studimi për të evituar rezultatet e gabuara nga mungesa e informacionit në lidhje me termin dekonjestionant të sferës së ORL. Për grupmoshën 4-18 vjeç formulari u plotësua në praninë e prindërve.

Rezultatet: Në studim u përfshinë 300 të anketuar. Gjatë një vizite mjekësore vetëm 40.3% e tyre ishin informuar për efektet e padëshiruara. Ndërsa në farmaci 85% e tyre ishin informuar nga farmacisti për mënyrën e përdorimit dhe ishin indikuar për të lexuar efektet anësore në fletën shoqëruese të medikamentit. 59.3 % i përdornin gjithmonë dekonjestionantët nazale gjatë një gjendjeje virale apo alergjike, 76.3% e të anketuarve i përdornin gjithmonë dekonjestionantët oralë në gjendje virale. Vetëm 10% e të anketuarve kishin lexuar fletëudhëzuesit e medikamenteve.

Konkluzioni: Gjatë këtij studimi u vu re që ka një keqinformim dhe keqpërdorim të dekonjestionantëve të sferës së ORL-së në Shqipëri. Abuzimi me këto medikamente është i dukshëm: 59.3 % i përdornin gjithmonë dekonjestionantët nazale gjatë një riniti, gjendjeje virale. 76.3% e të anketuarve i përdornin gjithmonë dekonjestionantët orale në gjendje virale.

Fjalët çelës: *Dekongjestionantë nazalë dhe oralë, efekte të padëshiruara, informimi publik.*

THE LACK OF PUBLIC INFORMATION ON DECONGESTANTS OF ORL AREA

Abstract

Introduction: The American Journal of Emergency Medicine (2007) published a case report of an ischemic stroke in a man with naphazoline abuse history. No risk factors for cerebrovascular events were found in his clinical history. Several studies raised the hypothetical idea that oral and nasal decongestants can cause cardiovascular and neurological problems if they are misused.

Aim: This study aims to get information on Albanians' use of oral and nasal decongestants and if they are informed on the side effects of these drugs.

Methodology: 300 persons fulfilled a questionnaire on the use of these drugs. The term "oral and nasal decongestants" was explained. The age group of 4-18 years old was accompanied by their parents.

Results: 300 persons fulfilled a questionnaire on oral and nasal decongestants. 40.3% of them were informed on the use and the side effects of decongestants during a medical consult. 85% of them were informed on the use of these drugs by different pharmacists and were advised to consult the drug factsheets. 59.3% of the surveyed persons always use nasal decongestants in case of rhinitis and 76.3% of them always use oral decongestants in case of viral conditions. Only 10% used to consult the drug factsheets.

Conclusions: Albanians are misinformed so they misuse these drugs. They abuse with them: 59.3% of the surveys individuals always use nasal decongestants in case of rhinitis and 76.3% always use oral decongestants in case of viral conditions. Only 10% used to consult the drug factsheets.

Key words: *Nasal and oral decongestants, side effects, and public information.*

Hyrje

Dekongjestionantët e sferës së ORL janë medikamente të cilat përdoren për të ulur kongjestionin nazal. Janë simpatomimetikë të cilët mund të përdoren në rrugë nazale dhe orale. Këto medikamente sigurojnë një lehtësim të përkohshëm të kongjestionit nazal në rastet e virozave, riniteve alergjike, ndryshimeve të presionit në kanalën e veshit, në sinuzite etj. Dihet që dhe një medikament që hidhet në treg pasi është liçensuar vazhdon të mbikëqyret për efektet e mundshme anësore që mund të vihen re në përdorimin afatgjatë të tij apo në grupe të ndryshme popullatash. Dhe është pikërisht farmakovigjilenca që vigjilon këto efekte anësore në kohë. Përsa i përket dekongjestionantëve të sferës së ORL njihet efekti i tyre simpatomimetik, por jo aq i fuqishëm sa për të pritur efekte të padëshiruara në sistemin neurologjik dhe kardiovaskular. Mjaftoi një raportim rasti (case report) që në botë të ngrihet alarmi në lidhje me efektet e tyre të rënda në pacientë. Në American Journal of Emergency Medicine (2007) bëri bujë raportimi i rastit të një pacienti 45 vjeçar, që pësoi ishemi cerebrale pas një historie të gjatë të përdorimit të nafazolinës nazale. Pacienti kishte një histori 20 vjeçare të përdorimit të nafazolinës për shkak të rinitit alergjik kronik. Pasi pacientit iu kryen ekzaminimet përkatëse u arrit në konkluzionin që nuk rezultonte asnjë faktor tjetër rrisht që të shpjegonte isheminë cerebrale. Një vit më vonë në 2008 Komisioni Kombëtar i Farmakovigjilencës në Francë raportoi një studim të kryer në lidhje me efektet e mundshme anësore të dekongjestionantëve. U raportuan raste me efekte të rënda në sistemin kardiovaskular dhe atë neurologjik ose të dyja njëkohësisht. Ndër efektet e rëndësishme kardiovaskulare përmendim: anginën, infarktën e miokardit, hipotensionin, arrestin kardial, insuficiencën kardiake, blloqet atrio-ventrikulare. Në sistemin neurologjik përmendim: hemorragjitë cerebrale dhe ishemitë cerebrale. Bazuar në rastet e raportuara dhe në studimin e Komisionit Kombëtar të Farmakovigjilencës në Francë lindi pyetja që përballë efekteve të padëshiruara kaq madhore sa është niveli i informimit publik në Shqipëri në lidhje me mënyrën e përdorimit të këtyre medikamenteve dhe risqet e tyre të mundshme. Dhe më konkretisht sa të kujdesshëm janë mjekët në informimin e pacientëve në lidhje me përdorimin e këtyre medikamenteve. Roli i farmacistëve në informimin dhe këshillimin për të lexuar gjithmonë fletë-udhëzuesit e medikamenteve. Sa të kujdesshëm janë vetë pacientët në kërkimin e informacionit dhe cili është burimi kryesor i informacionit rreth përdorimit të dekongjestionanteve. Pra kam synuar që bazuar dhe në studime botërore, të cilat deklarojnë riskun e mundshëm të këtyre medikamenteve, të nxjerr disa përfundime të rëndësishme dhe në lidhje me pacientët në Shqipëri.

Metodologjia

Ky studim përfshiu 300 të anketuar, të cilët u përzgjedhën në mënyrë rastësore. Kalimtarët plotësuan një pyetësor në lidhje me dekongjestionantët e sferës së ORL-së. U përfshinë grupmosha nga 4 deri në

Mungesa e informimit publik në lidhje me përdorimin e dekonjestionantëve të sferës së ORL-së

80 vjet të cilët iu nënshtruan pyetjeve të hapura dhe të mbyllura në lidhje me këto medikamente. Për grupmoshën 4 deri në 18 vjet anketa u plotësua në prani të prindërit shoqërues. Të anketuarit u sqaruan se për cilat medikamente kryhej ky studim dhe iu shpjeguan me fjalë të thjeshta termat mjekësore. Ndër pyetjet e pyetësorit përmendim: si ishin informuar për përdorimin e këtyre medikamenteve, a i kishin përdorur ndonjëherë dekonjestionantët nazalë dhe oralë pa rekomandimin e mjekut, nëse ishin ose jo në dijeni të disa efekteve anësore, nëse gjatë një vizite mjekësore mjeku u kishte sqaruar ose jo efektet anësore të tyre dhe mënyrën e përdorimit, nëse farmacistët i udhëzojnë ose jo të lexojnë fletën shoqëruese të medikamenteve dhe rastet në të cilat i përdornin këto medikamente. Pas plotësimit të pyetësorit u analizuan të dhënat për të nxjerrë një konkluzion në lidhje me informimin publik në Shqipëri ndaj kongjestionantëve të sferës së ORL-së.

Rezultatet

Në këtë studim u përfshinë 300 individë ku femrat zinin 57% të të anketuarve dhe meshkujt 43%. Mosha minimale e përfshirë në studim është 4 vjet dhe maksimalja 80 vjet. Grupmoshat janë shpërndarë sipas tabelës 1.

Tabela 1. Shpërndarja sipas grupmoshës

GRUPMOSHA	TË ANKETUARIT
4 deri 18	25
19-40	117
41-60	100
61-80	58



Pra sikurse vihet re mbizotëron grupmosha 19 deri 40 vjet me 39% dhe grupmosha 41-60 vjet me 33.33%. Të anketuarit u pyetën se si ishin njohur më përpara me këto medikamente (Tabela 2), dhe rezultoi që publiciteti, farmacistët dhe të afërmit/ miqtë ishin rekomanduesit e parë përkatësisht me 31.33%, 28.33%, 27%.

Tabela 2. Burimi i parë i informacionit për dekonjestionantët nazalë dhe oralë

Burimi i parë i informacionit	Nr. i të anketuarve
Publiciteti	94
Të afërmit/ miqtë	81
Farmacistët	85
Mjekët	40

Mjekët zinin një përqindje shumë të ulët në lidhje me informacionin e parë që kishin marrë të anketuarit për këto medikamente, rreth 13.33%.

91% e të anketuarve kishin përdorur dekonjestionantët nazale të paktën një herë pa rekomandimin e mjekut, dhe rreth 94% e tyre kishin përdorur ato oralë pa rekomandimin e mjekut (Grafiku 1 dhe 2).

Grafiku 1. Përdorimi i dekongjestionantëve nazalë pa rekomandim mjeku**Grafiku 2.** Përdorimi i dekongjestionantëve oralë pa rekomandim mjeku

Në një nga pyetjet parashtroheshin disa efekte anësore të këtyre medikamenteve dhe të anketuarit duhet të përgjigjeshin nëse ishin në dijeni të tyre ose jo. Vetëm 40% e tyre ishin në dijeni të këtyre efekteve anësore. Rreth 40.33% të tyre u janë shpjeguar efektet anësore të dekongjestionantëve gjatë një vizite mjekësore dhe vetëm 85% të tyre u është shpjeguar nga farmacisti mënyra e përdorimit të këtyre medikamenteve dhe janë udhëzuar të konsultojnë fletën shoqëruese të barnave. Këtë këshillë e kanë respektuar 10% e të anketuarve. 59.3 % i përdornin gjithmonë dekongjestionantët nazalë gjatë një gjendjeje virale apo alergjike, 76.3% e të anketuarve i përdornin gjithmonë dekongjestionantët oralë në gjendje virale.

Diskutim

Nga ky studim u vu re që ka një keqinformim në lidhje me dekongjestionantët e sferës së ORL-së në Shqipëri. Të anketuarit si burim të parë informacioni për këto medikamente kishin fushatat publicitare, rekomandimet nga të njohurit/ të afërmit e tyre dhe farmacistët. Dhe një përqindje shumë të vogël e zinin mjekët. Nga ana tjetër kjo mungesë informacioni bën që në Shqipëri të përdoren shpesh si medikamente pa u rekomanduar nga mjeku qoftë dekongjestionantët oralë dhe ata nazalë. Dhe në rastet që këto medikamente janë rekomanduar nga mjeku apo farmacisti vlen për t'u theksuar që vetëm 40.33% e të anketuarve janë informuar nga mjeku për efektet anësore dhe 85% e tyre janë udhëzuar nga farmacisti për të lexuar fletën shoqëruese të medikamentit, nga të cilët vetëm 10% e kanë ndjekur këtë këshillë. Abuzimi me këto medikamente shkon deri aty sa 59.3 % i përdornin gjithmonë dekongjestionantët nazalë gjatë një gjendjeje virale apo alergjike, 76.3% e të anketuarve i përdornin gjithmonë dekongjestionantët oralë në gjendje virale.

Përfundime

Në përfundim të këtij studimi, ku vihet re qartë mungesa e informacionit publik në lidhje me përdorimin dhe efektet anësore të këtyre medikamenteve, duhet punuar për informimin e gjerë në lidhje me efektet e reja anësore të dekongjestionantëve të sferës së ORL-së. Informimi duhet të nisë nga personeli mjekësor, farmacistët e të shtrihet në nivel të gjerë publik në mënyrë që të nxitet përgjegjshmëria në përdorimin e këtyre medikamenteve për të evituar efektet e rënda anësore prej abuzimit.

Referenca

1. Jacqueline L. Longe, Project Editor, The Gale Encyclopedia of Medicine, third edition, Thomson Corporation, 2006; 1115-1117.
2. Giorgio Costantino, Elisa Ceriani, Giulia Sandrone, Nicola Montano, Ischemic stroke in a man with naphasoline abuse history, American Journal of Emergency Medicine (October 2007) volume 25, issue 8; 83.e1-983.e2.
3. AFSSAP Direction de l'Evaluation des Médicaments et des Produits Biologiques *Unité de Pharmacovigilance*, Saint-Denis, le 20 mai 2008, Compte rendu de la réunion du mardi 25 mars 2008 ; 10-14.
4. Olivier, P., Dugue, A., Montastruc, J.L. Adverse cardiovascular and central results of the French National Pharmacovigilance Survey. *Thérapie* 2003; 58.361-6.